

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

### Afrueshmëria<sup>1</sup> / *el-Inbisaat* / الأنبساط

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha, duke cituar *keliim-in*<sup>2</sup> ﷻ e Tij:

"أَتُهْلِكُنَا بِمَا فَعَلَ السُّفَهَاءُ مِنَّا إِن هِيَ إِلَّا فِتْنَتُكَ تُضِلُّ بِهَا مَن تَشَاءُ وَتَهْدِي مَن تَشَاءُ."

"A do të na shkatërrosh për atë çfarë bënë të marrët mes nesh! Kjo s'është gjë tjetër veçse një sprovë Jotja nëpërmjet së cilës Ti humb kë të duash dhe udhëzon kë të duash." (el-A'raf, 7)

Afrueshmëri do të thotë të sillesh në mënyrë të natyrshme, duke iu shmangur veçimit që mund të vijë nga përnderimi i tepërt.<sup>3</sup> Kjo nënkupton që ta ndjekësh natyrën tënde dhe ka tri nivele:

Niveli i parë është të jesh i afrueshëm me krijesat dhe kjo arrihet:

- Duke mos u veçuar (izoluar) nga ta për ta ruajtur kohën ose ndonjë interes tëndin
- Duke u ofruar vazhdimisht favore atyre dhe duke i pajtuar me mirësjelljen tënde
- Duke i lënë ata të të shkelin<sup>4</sup>

Tërë këtë ndërsa ti ke parasysh dijen (e Shpalljes) dhe zbaton kuptimet (e qëllimit të ekzistencës).<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Afrueshmëria (*Inbisaat*) po ashtu mund të përkthehet si thjeshtësi apo lirshmëri. Përnderimi që ti i bën Allahut, nuk duhet të të pengojë nga pasja e raporteve dashuruese me Të, gjë që ngërthen lirshmëri, spontanitet, dhe qetësim.

<sup>2</sup> Atij që Allahu i foli drejtpërsëdrejti – Musa ﷺ.

<sup>3</sup> Kur të gjendesh afër (bashkë / *xhem'ijjah*) me Allahun, mos lërë që përnderimi ndaj Tij të ta heqë kënaqësinë e shoqërimit me Të dhe ngushëllimin qetësues (*uns*) që vjen nga afërsia ndaj Tij.

<sup>4</sup> Kjo s'është për të trimëruar shkelësit (zullumqarët), por për të qenë i lehtë duke hequr dorë nga disa të drejta tuat për dobinë më të madhe të përfitimit të zemrave të njerëzve dhe, çka është më e rëndësishme, kënaqjes së Zotit.

Niveli i dytë është të jesh i afrueshëm me Krijuesin dhe kjo arrihet:

- Duke mos lënë frikën të të kufizojë
- Duke mos lënë shpresën të të ndalojë<sup>6</sup>
- Duke mos lënë Ademin ose Havanë të qëndrojnë mes teje dhe Atij<sup>7</sup>

Niveli i tretë është të përmbahesh me zell nga afrueshmëria, meqë afrueshmëria e robit tash vjen duke u zhbërë në shtrirjen e haresë (*bast*) së të Vërtetit, e lartësuar qoftë madhëria e Tij!

---

<sup>5</sup> Ti s'bën të lejosh që afrueshmëria dhe mirëdashja më njerëz të të bëjë t'i kalosh kufijtë e shariatit, që njihen nëpërmjet njohjes së Shpalljes, dhe as të ta heqin vëmendjen nga zbatimi i kuptimit kryesor të ekzistencës sate – të jesh me Allahun dhe të kërkosh kënaqësinë e Tij.

<sup>6</sup> Shpresa për shpërblim të menjëhershëm mund të të ndalojë nga kërkimi i kënaqësisë së Tij. Kjo po ashtu mund të të bëjë artificialisht të nënshtuar (të pasinqertë), gjë që të parandalon nga afrueshmëria me Të.

<sup>7</sup> Kjo po ashtu mund të nënkuptojë çdo mashkull ose femër, ose mund të nënkuptojë që të shohësh (vësh re) krijimin tënd nga Ai pa mediume (ndërmjetës), duke të lënë kështu të vendosësh një lidhje të drejtpërdrejtë me Të.